



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Gramsh më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË.**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** "Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh";

**KODI NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punime ndërtimi për prita - 45247240-4

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 82,035,740 (tetëdhjetë e dy milion e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqindë e dyzet) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Bashkia Gramsh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1
- b. Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas Shtojcës 2
- c. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3
- d. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8

**Argumentimi:** Njesia e Prokurimit për pikat a. dhe b. bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", seksioni III, neni 39, pika 7, gërma "ç". Kërkesa për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për

*Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Sipas këtij konteksti, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore gjatë tre viteve 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros per periudhën e kërkuar duhet të jetë *jo më e vogël se vlera e fondit limit të objektit që prokurohet*. Për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania.

**\* Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.**

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar” si dhe nenin 43, pika 2-b e VKM-se, nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se; “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 1, të nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

**Fondi limit** = 82,035,740 (tetëdhjetë e dy milion e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqindë e dyzet) lekë pa TVSH

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilancit për tre vitet 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt - Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm kur janë në kushtet e ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, kreu V, neni 41, pika c.

**\* Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

**Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara është bërë duke iu referuar Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, sidhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” ku përcaktohet se:- “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c, të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël

**2.2.3 Vërtetimi të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2023 dhe kesteve të maturuara për vitin 2024, në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.**

**Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.**

**\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

**Shënim:** Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mësipërm.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vendosija e kërkesës për detyrimet vendore është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Shlyerja e detyrimeve vendore për operatorët ekonomik pjesëmarrës vërteton se ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në përputhje me rregullat e përcaktuara nga autoritetet vendore nëpërmjet Vendimeve të Këshillave Bashkiak. Po ashtu, njësia e prokurimit gjykon se, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të aktivitetit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin

të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vëndet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku në rast se oferta paraqitet si bashkim operatorësh ekonomikë, në zbatim të pikës 3 të nenit 88 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021,shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore duhet të vërtetohet nga secili anëtar.

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme sipas percaktimeve të VKM-se Nr. 285, datë 19.5.2021, neni 39, pika 5:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës të fondit limit të objektit që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*ose*

b) Pune te ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e puneve te kryera e marre se bashku gjate pese viteve te fundit te jete jo me e vogel se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet

**\* Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

*Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim, anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në këtë bashkim.*

*Në rastin kur operatorët ekonomikë anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht.Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtem:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike:

- Kontratë sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)
- Çertifikaten e marrjes në dorëzim/ Çertifikatën e përkohshme të marrjes në dorëzim
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas Shtojcës Nr. 9
- Fature Tatimore

*Shënim: Formulari i vlerësimit ne rastin e punes se ngjashme te kryer nga BOE duhet te tregoje saktesisht % e ndarjes se punes midis OE. Paraqitja e nje formulari te mbushur jo sipas formatit zyrtar, do te kosiderohet kusht per mos njohjen e punes respektive.*

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat:

- Kontrate sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)
- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat, për kyerjen me sukses të kontratës
- Fatura tatimore të situacionit përfundimtar

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku citohet se: ‘Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën’ si dhe Nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, dt 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”. Referuar këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht jo më të vogël se 50% e vlerës të fondit limit (që prokurohet) për një objekt të vetëm, ose jo më e ulët se dyfishi i fondit limit të objektit që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Në rastet e Bashkimit të Operatoreve, për një vlerësimin sa më real të ofertave, është konstatuar se Komisionet e Vlerësimit të Ofertave hasin vështirësi për vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, në rastet kur në formularët e vlerësimit nuk përcaktohen përqindjet e pjesëmarrjes të secilit operator në bashkim, pasi në disa raste institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar, për rrjedhojë është e domosdoshme që Operatorët Ekonomikë kur paraqesin formulare vlerësimi të plotësuar korektesisht ku të përcaktohen përqindjet përkatëse të ndarjes dhe realizimit të punës nga OE pjestare në një BOE. Në rast të kundërt OE duhet të paraqesin kontratën e bashkëpunimit midis tyre. Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

**2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt i Lotit që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :**

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

**N.P. -1 B Punime gjurmimi në tokë.**

**N.P. - 9 C Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.**

## **Për punimet speciale të ndërtimit:**

N.S.-18 B Punime topogjeodezike.

*Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persipër të realizojë.*

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilët përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilët përcaktohet se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”; Gjithashtu bazuar dhe në VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përllogaritur të kontratës.

**N.P.– 1Kategoria B “Punime gjërmimi në tokë”.(21 – 50 milion leke)**

*Konsiderohen gjërimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloji mjete, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv,

**N.P. – 9 Kategoria C “Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime”.(51 – 100 milion leke)**

*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemin dhe*

vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

### **N.S. - 18 Kategoria B “Punime topogjeodezike”.(21 - 50 milion leke)**

*Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh*

Kjo kategori licence i referohet punimeve topografike të parashikuara në projekt.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<b>Kategoria e kërkuar</b>	<b>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</b>	<b>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</b>	<b>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</b>
N.P - 1	Punime gjurmimi + sistemimi në tokë	Punime gjurmim dheu	B
N.P - 9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Gabion me rrjete teli te zinguar dhe beton.	C
N.S - 18	Punimetopogjeodezike	Zbatimiriilevimevetopografike, punimevetopogjeodezikeetj.	B

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese**, si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi (Profili Gjeoteknik) - 1 (nje)
- Inxhinier Topograf - 1 (nje)

Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Mjedisi - 1 (nje)
- Inxhinier Gjeolog - 1 (nje)

**Nese operatori ekonomik ofertues nuk disponon nje Inxhinier Mjedisi mund të paraqesë një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e kerkuar, jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi si dhe te plotesoje kerkesat e mesiperme.**

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.
- Libreze pune.
- Të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë .
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

*Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë inxhinieret e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Gjithashtu OE duhet të disponojë:

- a. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjësin/Drejtuesin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.
- b. Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë “Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 “Për sigurinë në kantier”, VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.
- c. Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) punojës i cili të jetë i pajisur me certifikatë “Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajit e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.



d. Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” i ndryshuar, ku për përmbushjen e këtij kushti te jete i shoqëruar me kontratë pune të vlefshme ose kontratë shërbimi ne rastin kur OE nuk disponon nje te tille, Licensen leshuar nga Urdhëri iMjekut, dhe Diplomësi dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave (ne rastin kur eshte pjese e stafit te OE)

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

**\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mësipërm.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kupërcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, nenit 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/c dhe c të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se : Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: .. c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose .. c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; si dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar.

Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt, duhet të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jenë te angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në VKM-ne Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, konkretisht: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “Elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në

bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën Profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Ne mbrojtjet lumore, si pasojë e kushteve klimaterike terreni është në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe referuar zerave të preventivit, rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë Ndërtimi, Hidroteknik, Topograf, dhe Gjeoteknik. Nderkohe që Inxh Mjedisit është i domosdoshëm në këte prokurim për arsye se të dyja krahet e lumit ku do të zhvillohet mbrojtja prej një gjatësie 1 km janë të populluara. Inxh i Mjedisit duhet për garantimin e cilesise se punimeve në përputhje me kërkesat e mjedisit pereth në menyre qe punimet te mos shkaktojne ndikim ne mjedis. Qëndrueshmëria e tij në punë me kohështirje për periudhën e 3 muajve të fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Kërkesa për Pergjegjesin Teknikte Kantieri është përcaktuar bazuar në Kreun I/2.1 të Udhezimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastiit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Kërkesa për Pergjegjesin për Shëndetin dhe Sigurinë në Pune, mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM-ne Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores - Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos në këte kontrate ku dhe numuri I punojësve të kërkuar për realizimin e saj është i lartë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: “Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.”

Kërkesa për punojësin i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatë “Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, - Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep çertifikatë për personat fizikë e juridikë për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit zjarrfikës privat, në bazë të kritereve të veçanta të miratuara me udhëzim të ministrit

Kërkesa për mjekun bazohet në marrjen e masave për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, në zbatim të nenit 23 të ligjit Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” në të cilin përcaktohet se, citojmë: “1. Çdo punëdhënësi i një subjekti publik apo privat, vendas apo i huaj, është i detyruar të mbulojë me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës.”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.632, datë 15.07.2015), në të cilin ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:... b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit;...” duke qënë se është detyrim ligjor mbulimi me shërbim mjekësor të ndërmarrjes nga ana e punëdhënësit, dhe mbulimi i këtij shërbimi në aspektin shëndetësor duhet të kryhet nga mjeku i punës i licencuar, njësia e

prokurimit vlerëson se kërkesa për disponimin e mjekut të ndërmarrjes ose të kontraktuar është një detyrim ligjor për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar në përputhje me ligjin, duhet vërtetojnë disponimin e tij.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve të mëposhtëme:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Gjeolog	1 (nje)
- Teknik Gjeodet/Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)
- Murator	9 (nente)
- Karpentier	9 (nente)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Hidroizolues	1 (nje)
- Punonjes Guri/Gurepunues	10 (dhjete)

❖ **Shënim:** Gjate fazes së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punës, subjektin leshues të certifikates/diplomes, Nipt (në rastin kur subjekt leshues i certifikates/diplomes është privat).

*Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licensuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.*

**\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

Per punonjësit e mesiperm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punonjësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndërtimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet të paraqitet dhe deftese e shkollës së mesme.

*Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të kualifikuar** për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin

profesional, sipas profileve te më poshtëme:

- Manovrator/eskavatoriste	4 (kater)
- Automakinist	3 (tre)
- Shofer kamjoni	8 (tete)

- ❖ **Shënim:** Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste/manovrator, automakinist, buldozierist dhe shofer, **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

**\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

**Shënim:** Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Dëshmi te Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .

**Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

**Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.**

**Argumentimi:**Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, nenit 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/c dhe c dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se : Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: .. b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose .. c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin

me sukses të kontratës. Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, si dhe referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe referuar Kodit Rrugor.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me dokumentat e tenderit) Punetoret e specializuara në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarohet se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre. Specialistët Muratore dhe Karpentiere, Dhe spocialiste guri jane te domosdoshem pasi zeri kryesor i ketij prokurimi jane profilat mbrojtjes mbushur me gure kave si dhe blloqet e betonit. Nga zberthimi i zerave te preventivit lidhur me grafikun e punimeve del se duhen me patjeter numuri i kerkuar i ketyre punojesve. Manovratorët, automakinistët dhe shoferët gjithashtu zene nje vend te rendesishem ne kete procedure pasi nga zberthimi i zerave te preventivit lidhur me grafikun e punimeve dhe me zberthimin e punimeve sipas analizave perkatese del.

Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Kërkesa që certifikimet e punojesve të deklarohen që në fazën e ofertimit bëhet për arsye që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi verifikimi për deklaratimet e bera nga Operatorët ofertues në mënyrë që të mos krijohen vonesa në procesin e shpalljes së operatorit fitues pasi këto investime janë emergjente dhe kanë domosdoshmëri të menjhanshme sa me parë të punimeve. Për më tepër, qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve të nevojshëm” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklarate do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve dhe profilin e tyre sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi. Njesia e Prokurimit në kuptim të fjalës **“duhet të deklarojë”** përcakton se ky deklaram është pjesë e dokumentave standarte të tenderit dhe si i tillë duhet të plotësohet nga OE ofertues. Kjo kërkesë nuk sjell kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në tender, kosto të shtuar për ta si dhe konfuzion në OE ofertues, pasi informacioni i kërkuar është pjesë e dosjes së secilit prej punojesve.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo më pak se **72 (shtatëdhjetë e dy)** punojesish në fushën e ndërtimit, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum, **3 (tre)** muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

**\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

**Shënim:** Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur

**Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Nga zberthimi i zerave te preventivit rezulton se per realizimin e kontrates Brenda grafikut nevojiten rreth 72 punonjes duke perfshire staf tekni, specialiste etjs. Duke gene se OE mund te punoje dhe ditet pushim si dhe me orare te zgjatura Brenda percaktimeve ligjore NJP ka kerkuar nje numur me te vogel punojeshish kjo dhe per te nxitur garen. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetime të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në kreun V, seksioni III, neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga Administratori, te detajuar sipas zërave të preventivit (bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit .**

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, seksioni III, neni 39, pika 3. ku percaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve”

**2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:**

<b>Makineri dhe pajisje</b>	<b>Nr.</b>	<b>Njesia</b>	<b>Gjendja</b>
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-3.5 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc	2	cope	Ne pronesi ose me qera

Eskavator me Goma (mjet teknologjik me goma)	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir me krah jo me pak se 18 m	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Fadrome (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Dumper (mjet teknologjik me goma)	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Grejder (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Rul ngjeshes me vibrim mbi 15t	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobot uji	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Autopompe Betoni	2	cope	Ne pronesi ose me qera
RTV - Transportier per mjete te renda	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Agregat per prerje bimesie	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Moto gjenerator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantieri	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Vibrues betoni	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Karoca dore	6	cope	Ne pronesi ose me qera
Moto pompe uji	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Kethyese hekuri / bango hekuri	1	cope	Ne pronesi ose me qera
G.P.S	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Total Station	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kokore	72	cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	72	cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalizuese kantieri	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Wellpoint	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Armaturë/betoforma/lendë drusore	500	M2	Ne pronesi ose me qera
Impiant prodhim betoni me QKL	1	cope	Nëpronësi, me qera, osekontratëfurnizimi
Nyje Inerte	1	cope	Nëpronësi, me qera, osekontratëfurnizimi

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

*Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:*

**a) Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:**

1. Dokument qe verteton pronesine e mjetit.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Leje transporti, leshuar nga pushteti vendor (e vlefshme)

**b) Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:**

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj (e vlefshme).

2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Leje trasporti per vete dhe te trete (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)

c) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeteve dhe targa e tij.

d) Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim të verifikimit nga Autoriteti Kontraktor

*Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet RTV – Transportues për mjetet e renda mund të paraqesë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për gjithë periudhën që zgjasin punimet.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për përjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj. Nga zberthimit i zerave të preventivit konkretisht rezulton se janë një sasi e konsiderueshme inerte dhe gure për tu zhvendosur dhe për tu sjelle në kantier. Nderkohe që rezulton se nevojiten për realizimin e kontratës rreth 1140 ore pune me mjete të renda (eskavator, skrep, fadrome, rul etj) Kërkesa për mjete të renda specifike si eskavatore krahegjate, nevojitet si shkak i gjerësisë tepër të madhe të lumit në pjesën ku do të zhvillohet mbrojtja cka krijon problematika në devijimin e lumit si dhe thellesisë në pjesën ku do të zhvillohet mbrojtja si shkak i gjerësisë së vazhdueshme. Sasia e mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

## 2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:



- a) Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- b) Certifikatë **ISO 45001:2018** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë”,(e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim
- c) Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim
- d) Operatori Ekonomik të ketë Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III. 2. B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta, inerte”. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet ne Republikën e Shqipërisë”) Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25, se bashku me aktin e miratimit .

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Per sa i takon kërkeses per Lejen Mjedisore me **Kod III.2.B** “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve të llojeve të ndryshme” bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku specifikohet se : “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Gjithashtu ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontratës, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojnë një kujdes maksimal në transportin e mbetjeve inerte që dalin gjat punimeve dhe germimeve si transportin e tyre, me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga aponëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL)

dhedisarregullimetëtjeteranënligjoretëpërbashkëta”, i ndryshuarsi dheeshtebazuarneprojekt-preventivin

2.4.2 Operatori ekonomik ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne DST, per materialet si më poshtë:

- a) Beton
- b) Inerte
- c) Hekur
- d) Rjete celiku

Duhet te paraqese:

1. Autorizim te Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument të paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese autorizimin e mesiperem, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter vendoset bazuar ne zerat e preventivit te punimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit, duke marre ne konsiderate se rendesine e zones ku do te kryhen punimet shfaqet e nevojshme qe per mallrat qe do te perdoren ne realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor te garantohet qe keto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor te autorizuar. AK duhet te jete i garantuar se operatori ekonomik ka garancine e furnizimit me keto produkte ne sasine dhe kohen e duhur per realizimin e vepres.

2.4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në rast të shpalljes fitues.

**Argumentimi:** Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe te pika 2.10 e DST-ve. Financimi është parashikuar i ndare ne dy vite.

2.4.4 Vetëdeklarim, sipas deklaratës në vijim, ku të evidentohen objektet dhe vlerat përkatëse të kontratave, nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/ nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti

kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

## DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS

(Për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoritetikontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallurfituese

**Argumentimi :** Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të parashikimeve ligjore të Kreut III, të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku parashikohet:

b) *Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencura kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “*periudhë*” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.*

**\*Shënim:** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare, kapacitetet teknike si dhe burimet njerezore, sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Kjo vlen edhe për ata OE të cilët janë shpallur fitues nga DUK Korce dhe kanë kontrata ende në proces pune.*

**\*Shënim:** *Operatorët ekonomik gjatë plotësimit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8, duhet të kenë parasysh përcaktimet e dokumentit “Sjellje në Vëmendje”, Nr. 918 prot., datë 02.02.2022, të publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. si dhe ndryshimet e ligjit Nr 162 “Per Prokurimin Publik” hyre ne fuqi dt 20.03.2024.*

**\*Shënim:** *Të gjitha dokumentat e kërkuara më sipër si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike, duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

***Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti sipas kërkesave ne DST, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.***

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit janë hartuar nga inxhinierë, anëtarë të Njesisë së Prokurimit, bashkëngjitur DST ne SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga anëtarët specialistë të Njesisë së Prokurimit.

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**ANËTAR**  
Orgent ÇONIKU

**ANËTAR**  
Muhamet AJAZI

**ZYRTARI I AUTORIZUAR  
N/KRYETARI I BASHKISË**  
Tajar BICI

*Konceptoi: Njesia  
Miratoi: T.Bici  
Konfirmoi:  
Dosja nr: \_\_\_\_\_  
Afati i ruajtjes: \_\_\_\_\_*